



**Agjencia e Mbikëqyrjes Policore**

## DHJETOR 2022

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.

Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

## MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

### Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë




[ankesa@amp.gov.al](mailto:ankesa@amp.gov.al)




0800 90 90

### Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



[denonco@amp.gov.al](mailto:denonco@amp.gov.al)



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë

### Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë DVP-ve në Qarqe

### Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



[www.amp.gov.al](http://www.amp.gov.al)



## VEPRIME HETIMORE

### Referimet e bëra në Prokurori

**21** referime në Prokurori për **22** punonjës të Policisë së Shtetit dhe **5** shtetas për vepra të ndryshme penale.

### Arrestuar/ndaluar në flagrancë

**4** punonjës policie dhe **3** shtetas të arrestuar në flagrancë

### Ekzekutimet e vendimeve të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

- Vendosur masa e sigurimit "Arrest në burg": **1** shtetas
- Vendosur masa e sigurimit "Pezullim i ushtrimit të një shërbimi publik": **1** shtetas

## INSPEKTIVE/VENDIME

Gjatë muajit Dhjetor janë kryer **15** inspektive nga të cilat ka rezultuar se për **1** rast i është rekomanduar Policisë së Shtetit fillimi i hetimit disiplinor për "shkelje të lehtë" ndaj një punonjësi policie.

Gjatë muajit Dhjetor, Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar në total **15** praktika disiplinore, nga të cilat në **3** raste është konstatuar dhe vendosur fillimin e hetimit disiplinor për **3** punonjës policie, ndërsa në **12** raste ka konstatuar dhe vendosur mosfillimin e hetimit disiplinor si më poshtë:

- Në **3** raste, për **3** punonjës, nepunës civil ose punonjës administrativë, të cilet në bazë të nenit 5, pika 2, të ligjit 128/2021, nuk janë subjekt i mbikëqyrjes së Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe për rrjedhojë, as i Komisionit Disiplinor.
- Në **3** raste, për **4** punonjës policie nuk janë konstatuar shkelje administrative të procedurave standarde të punës
- Në **1** rast, për **1** punonjës policie, shkelja e disiplinore e kryer nuk është konstatuar nga AMP, e cila ka marrë dijeni për rastin pas fillimit të hetimit disiplinor nga DSP
- Në **5** raste, për **5** punonjës policie, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është njohur me vendimin për dhënie mase disiplinore "Perjashtim nga Policia e Shtetit" nga Drejoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

## HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE

Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun



**375 Telefonata**

në linjën e gjelbër **08009090**, nga të cilat:

**159** telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP (Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)

**87** telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP (Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)

**129** telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit (Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



## Ankesa të trajtuara

Ky grup nënkupton përfundimin e trajtimit të ankesës dhe kthimin e përgjigjes për qytetarin.

**197 ankesa**



## Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo ankese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

**84 ankesa**